

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE
DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE
DIREKCIJA ZA ZDRAVSTVO I SOCIAJALNU ZAŠTITU



Bazuar në nenin 67.dhe 68.të Ligjit për Zyrtarët Publik,nr.06/L-114, 8. të Ligjit të Punës nr.03/L-21 2,nenin 5.të Kontratës Kolektive sektoriale dhe Kërkesë-propozimit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare :“Dr.Fatmir Krasniqi” Fushë Kosovë,shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Për themelimin e mardhënies së punës me afat të pacaktuar

- I.Titulli i vendit të punës:Doktor i mjekësisë(Mjek/e i/e përgjithshëm/e)
- Institucioni:Komuna Fushë Kosovë
- Drejtoria: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Lloji i pozitës:Nëpunës i Shërbimit publik
- Numri i Pozitave:2 (dy)
- Titulli i mbikqyrësit:Shefi i Njesisë,Kryeshefi i departamentit të MF-QKMF-së
- Grada/koeficienti: H-27 Gr./St. H-659 7.2
- kohëzgjatja e emërimit: Në kohë të pacaktuar
- Vendi i punës: QKMF “Dr.Fatmir Krasniqi”Fushë Kosovë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

-Sipas përshkrimit të detyrave të punës në Qarkoren Informativ Nr.02/2017 (M.SH. dt.24/07/2017.
Ofron shërbime me standard të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi,
Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për individin/pacientin,
Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjeve,
Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë,
Ofron kujdes për rastet urgjente dhe i referon ato me kohë dhe në mënyrë adekuate,
Referon pacientin për trajtim spitalor,etj.

Kushtet dhe kriteret:

- të jet shtetas i/e Republikës së Kosovës (kopja e Letërnjoftimit),
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare,në pajtim me Ligjin mbi gjuhët,
- të jetë i/e aftë në pikëpamje shëndetësore (Certifikata e mjekut,pas pranimit në mardhënie pune),
- të mos jet i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje (dëshmi me shkrim nga Organi kompetent),
- të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e Zyrtarit publik,
- të ketë të kryer Fakultetin e Mjekësisë-drejtimi i përgjithshëm (diploma ose Certifikata(fotokopje) e vërtetuar),

- personat që kanë diplomuar jashtë R.së Kosovës, duhet të kenë të nostrifikuara diplomat në MASHT,
- të jetë i/e regjistruar dhe licencuar në M.SH. (Licenca e punës),
- të ketë aktivitete dhe trajnime të realizuara dhe të dëshmuara,
- të ketë shkathtësi pune i/e pavarur dhe në ekip,
- të ketë njohuri të punës me Kompjuterë dhe
- të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, etnie, religjioni ose race.

INFORMATË E PËRGJITHËSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Mënyra dhe afati i aplikimit

Pranimi në detyrë, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. Procesi përzgjedhës do të bazohet gjithashtu në një proces profesional, transparent e të drejtë, bazuar në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, ku përfshihet një testim me shkrim dhe me gojë.


Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net>, është nga data: 20/04/2021, deri më: 20/05/2021.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve, është 15 ditë, nga data: 21/05/2021, deri më: 04/06/2021, ora 15,00.

Përveç webfaqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës.

Aplikacionet merren në katin e II-të - Arkiva e QKMF-ës, ose mund të shkarkohet nga web-faqja zyrtare e Komunës së Fushë Kosovës, dhe të plotësuara dorëzohen personalisht në Arkivë të QKMF-së ose dërgohen me postë në adresën: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Fushë Kosovë, Rruga "Bedri Pejani" p.n.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakumpletuara nuk do të pranohen.



Drejtore i DSHMS,
Jakup Dumani

[Signature]